



Keshilli i Bashkisë Korçë

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr.____ datë26/05/2025

Nr.____Prot

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr.____ datë _____2025, relacionit dhe dokumentave shoqërues të projekt-vendimit, në lidhje me propozimin “PËR MIRATIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR NXËNËSIN RENIS MANKOLLARI, PËR PJESËMARRJEN E TIJ NË OLIMPIADËN NDËRKOMBËTARE TË MATEMATIKËS 2025”.

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore e propozimit të projekt-vendimit dhe e vendimit të Komisionit të Përhershëm – a është i mbështetur në ligj propozimi dhe vendimarrja)

Ligj in nr 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", ligjin nr. 9936 date 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, ligjin nr. 68 date 27.4.2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore", ligjin 11 5/2024 date 03.12.2024 "Per buxhetin e vitit 2025", udhezimin plotesues nr. 2 date 24.01.2025 "Per zbatimin e buxhetit te vitit 2025", udhezimin nr. 9 date 20.03.2018 i Ministrise se Financave dhe Ekonomise "Per procedurat standarde te zbatimit te buxhetit" i ndryshuar, VKB nr. 176 date 26.12.2024 "Mbi miratimin e buxhetit vjetor te vitit 2025 dhe PBA 2025-2027 te Bashkise Kor9e", si dhe urdherin nr.11 date 14.01.2025 "Per detajimin e shpenzimeve korrente per vitin 2025 te Bashkise dhe Institucioneve te Varesise sipas programeve dhe produkteve", i ndryshuar,

Komisioni e gjen të bazuar në ligj vendimarrjen.

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit – nëse konstatohet që ekziston nevoja për këtë vendim të propozuar dhe çfarë problematike zgjidh ai)

Në ushtrim të funksionit që ka Bashkia për motivimin e nxënësve ekselentë është e nevojshme të përballohen shpenzimet e udhëtimit të nxënësit Renis mankollari në Australi ku do të zhvillohet International Mathematical Olympiad (IMO) 2025 dhe ky nxënës do të përfaqësojë Shqipërinë.

Situata financiare : (Shtesa / pakësime në buxhet – a ka efekte në buxhet dhe a është parashikuar ap nevojitet buxhet shtesë për zbatimin e vendimit)

Mbështetja financiare do të realizohet nga fondi rezervë. Për këtë qëllim në projekt vendim janë parashikuar dhe lëvizjet në zërat buxhetore përkatës.

Drejtoria / Sektori përgjegjës (kush është sektori apo drejtoria që do të ngarkohet me zbatimin)
Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK për kryejrjen e shpenzimeve sipas dokumentave justifikues.

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron zbatimin, raporton dhe sa shpesh)
Drejtoria e Financës Buxhetit dhe MFK në bazë të dokumentave justifikues. Raportimi në raportin vjetor të buxhetit.

Impakti social / grupet që preken: (a ka efekte sociale, pozitive apo negative, grupet që preken dhe impakti që sjell vendimi)
Stimulimi dhe motivimi i të rinjve dhe nxënësve ekselentë me prirje të vecanta.

A është objekt i konsultimit publik: (A është projekt-vendimi subjekt i konsultimit publik në zbatim të Ligjit 139/2015 ?)

Jo

Komisioni i Përhershëm për “**Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare**”, i mbledhur me datën 26/05/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr.____ datë _____2025, relacionit dhe dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për ““PËR MIRATIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR NXËNËSIN RENIS MANKOLLARI, PËR PJESËMARRJEN E TIJ NË OLIMPIADËN NDËRKOMBËTARE TË MATEMATIKËS 2025” paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T’i propozojë Këshillit Bashkiak, miratimin e projektaktit

Argumentat e vendimmarrjes janë paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit

_____ **Kryetar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

_____ **Sekretar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

Datë 26/05/2025